

## Numërimi deri në ligjësi

- Derisa Kosova pret një ligj për të drejtat autoriale, KPM ngushton rrethin e transmetimit të piraterisë -

nga Arben Hajredinaj

Stacioneve televizive në Kosovë u është caktuar 31 marsi 2004, ora 23:59 si afat kohor për përmbushje të plotë të udhëzimeve të reja të Komisionerit të Përkohshëm për Media për respektimin e të drejtës autoriale. KPM në harmoni me ligjin ndërkombëtar dhe praktikën që kanë të bëjnë me mbrojtjen e pronës intelektuale, publikoi zyrtarisht udhëzimet që hynë në forcë më 1 janar 2004. Televizioneve të Kosovës u është dhënë një periudhë kalimtare që të bashkëpunojnë në tërësi me këto udhëzime deri më 1 prill. Secila leje e mediave transmetuese ka një paragraf në lejen mbi shfrytëzimin e të drejtave autoriale e cila e obligon "bartësin e licencës të mbledhë tërë autorizimet dhe të posedojë lejen për çfarëdo dhe të gjitha programet (duke përfshirë edhe muzikë nga CD apo mjete tjera) para se bartësi i licencës t'i transmetojë ato."

### Mediat

Lekë Zherka, drejtor i Kohavisionit në Prishtinë thotë se s'ka kurrfarë mundësie që televizionet me frekuencë kombëtare duke e përfshirë edhe KTV-në, të transmetojnë filma apo programe pirateri. Këto stacione njëkohësisht kanë mjaft probleme nga televizione tjera më të vogla private sa i përket të drejtave autoriale. Disa televizione në Ferizaj, Prishtinë dhe qendra tjera transmetojnë blloqe programesh sportive, filma dhe programe tjera vetëm duke u kycur në pranues digjitalë satelitorë, përderisa KTV-së i nevojitet që t'i blejë të gjitha pro-



*Piratët e piratuar... Kur një film i bujshëm siç është "Piratët e Karaibeve" ka premieren e tij në Prishtinë, është shumë e mundshëm se dikush mund ta gjej edhe në dyqanet e afërta të CD-ve në DVD piraterie.*

gramet, filmat dhe përfundimisht të gjitha programet që s'janë prodhim i saj. Licenca e tyre transmetuese definojnë qartë kriteret e mbrojtjes së të drejtave autoriale të cilat KTV duhet t'i respektojë. Z. Zherka theksoi se KTV ka nënshkruar një kontratë me televizionin Top Channel në Shqipëri, përderisa një stacion televiziv në Ferizaj kyçet në pranuesin satelitor dhe transmeton programet e njëjta televizive pa paguar apo kompensuar autorin ose kompaninë.

Florin Kelmendi, drejtor përgjegjës i RTV 21 në Prishtinë, thotë se pirateria në veçanti ka ndikim në marketingun e tyre televiziv. Televizionet tjera më të vogla private transmetojnë DVD filma piratë, programe të tjera e bile edhe programe të riedituara të RTV 21. Në anën tjetër, ai shtoi se stacionet tjera s'kanë mundësi të qëndrojnë në trend me filmat më të rinj pasi që janë shumë të shtrenjtë për t'i blerë. Ai tha se KPM tani më u ka dërguar vërejtje stacioneve

të vogla private televizive për ta ndërprerë transmetimin e filmave piratë dhe të respektojë licencën e tyre, por deri më tani pa ndonjë sukses.

Feim Kurhasani, drejtor i RTV Dukagjini thotë se pirateria ekziston gati në secilin televizion të Kosovës duke e përfshirë edhe stacionin e tij. Ai tha se transmetuesit kosovarë janë të obliguar të dorëzojnë kopje të kontratave të nënshkruara ndërmjet televizioneve dhe kompanive tjera që sigurojnë filma, seriale, muzikë dhe programe tjera. Në anën tjetër ai tha se marketingu i televizionit të tij ka pësuar nga pirateria e televizioneve tjera në rajonin e Pejës. Sipas z. Kurhasani, dy televizione në Prizren dhe Gjakovë kanë sinjal të fuqishëm transmetimi dhe përpos emetimit të filmave piratë ata gjithashtu kopjojnë programe nga RTV Dukagjini dhe stacione tjera televizive. Ka raste kur televizionet tjera në rajon ua kanë kopjuar programin e mëngjesit në tërësi!

"Padyshim se pirateria është duke na e dëmtuar shumë punën tonë", thotë Liridon Cahani, drejtor i RTK-së. "Ne kemi bërë përpjekje maksimale që t'i blejmë filmat e kualitetit më të lartë, të cilët i testuam një javë para vigillies së Vitit të Ri. Disa TV stacione tjera lokale private i kishin transmetuar filmat e njëjtë një apo dy ditë para natës së Vitit të Ri. Përveç humbjeve financiare, problemi ynë më i madh është humbja e shikuesve për shkak të konkurrencës ilegale nga TV stacionet lokale." Z. Cahani shtoi se duke e pasur parasysh faktin që çdo komunë e Kosovës ka 1 apo 2 televizione të tilla, atëherë dëmi i shkaktuar është edhe më i madh se në shikim të parë. Ai pohoi se RTK pëson nga konkurrenca e padrejtë përgjatë tërë territorit të Kosovës.

Është e qartë se kompanitë distribuese të filmave janë duke pësuar nga pirateria në Kosovë. Kinemaja ABC në Prishtinë është ankuar disa herë me rradhë.

Sipas KPM-së, ata kanë dërguar disa vërejtje TV transmetuesve privatë që vazhdimisht transmetojnë filma piratë, për të kërkuar dokumentacionin përkatës për të drejtat autoriale. Por, përderisa KPM është duke e ngushtuar rrethin e piraterisë në mediat transmetuese, pirateria s'është përjashtuar por më shumë është një rregull në rrugët e Kosovës veçanërisht në dyqanet përplot CD përballë shtabit të policisë në Prishtinë.

### NË KËTË NUMËR

**Prioritetet e OSBE-së për vitin 2004**

f.4,7 dhe 9

**Kur vendorët marrin përgjegjësitë**

f.5

**Të mësojmë nga njëri tjeri**

f. 8

**Dokumentari kurrë nuk përfundon**

f. 10



Ambasadori Paskal Fieski,  
shëf i misionit të OSBE-së në Kosovë

## Të dashur lexues të Detajeve

Para misionit të OSBE-së në Kosovë gjatë vitit 2004 janë shumë sfida. Ne do të vazhdojmë të luajmë rolin e plotë si Shtylla e III-të, shtylla e ndërtimit të institucioneve të administratës së Kombëve të Bashkuara në Kosovë.

Një Kosovë stabile duhet t'i ketë institucionet e afta që t'i plotësojnë obligimet e tyre vendore dhe ndërkombëtare, duke përfshirë kërkesat, 'Standardet për Kosovën'. Në mënyrë që të arrihet kjo, OSBE-ja do t'i ndihmojë institucionet e shoqërisë t'i kryejnë detyrat e tyre duke respektuar plotësisht vlerat demokratike univverzale- duke përfshirë interesat, të drejtat dhe përfaqësimin e të gjitha komuniteteve në Kosovë.

Por si mund të bëhet kjo saktësisht? Si do t'i ndihmojë OSBE-ja 'institucionet', themelet e çdo shoqërie, që të jetë stabile? Ky ka qenë synimi ynë gjatë gjithë jetës së Misionit të OSBE-së në Kosovë. Dhe ne do të koncentrohemi në zhvillimin e kapaciteteve të kosovarët në mënyrë që t'i kontrollojnë institucionet e veta dhe të sigurojnë përkrahjen e standardeve demokratike. Ne do të vazhdojmë të punojmë me 'Institucionet e Përkohshme Vetëqeverisëse të Kosovës' (IPVK) pasi që ato do të shtojnë përgjegjësitë në jetën publike, në jetën e përditshme të njerëzve në Kosovë. Por, ne gjithashtu do të përpiqemi të sigurojmë se

kjo përgjegjësi po ushtrohet me respekt të plotë të të drejtave të njeriut dhe se të gjitha komunitetet do të jenë në gjendje të marrin pjesë në të gjitha institucionet, pasi që institucionet e Kosovës janë pasqyrim i njerëzve të saj. Kjo arrihet në shumë mënyra; nga zhvillimi i aftësive dhe kapaciteteve të zyrtarëve të zgjedhur dhe publikë deri te promovimi i pjesëmarrjes së njerëzve dhe krijuesve të mendimeve në jetën publike.


Një standard tjetër mbi të cilin OSBE-ja ka fokusuar përpjekjet është edhe shteti ligjor, si një barazi para ligjit është një parakusht themelor për zbatueshmëri dhe qëndrueshmëri. OSBE-ja do të vazhdojë të ndihmojë në themelimin e një policie, drejtësie dhe një sistemi penal që funksionon mirë, bazuar në paanësi dhe respekt për të drejtat e njeriut. Shteti ligjor ende qëndron i besueshëm në praktikën e nivelit qendror dhe lokal. Qëllimi i përgjithshëm, një nga të cilët është në qendrën e punës së OSBE-së, është të përkrah të drejtat e të gjithë njerëzve në mënyrë që ata të jetojnë të lirë dhe të sigurtë si pjesëtarë të integruar plotësisht në shoqëri.

Tri strategjitë kryqëzuese, të shpërndara nëpër të gjitha aktivitetet e OSBE-së do të vazhdojnë të jenë prioritet për vitin 2004. E para: Sigurimi i kushteve të përshtatshme për minoritete që të qëndrojnë në Kosovë dhe për kthim të qëndrueshëm. E dyta: Përkrahja e pajtueshmërisë dhe tolerancës dhe e treta: Promovimi i të drejtës për kthim.

Të dashur lexues, OSBE si një Shtyllë e UNMKK-ut për ndërtimin institucional, ka krijuar disa institucione drejt arrijtes së qëllimit tonë të përkrahjes së Kosovës në tranzicion deri te një shoqëri demokratike bazuar në shtetin ligjor.

Të përkujtojmë shkurtimisht institucionet e krijuara nga OSBE-ja në të gjitha fushat e saj të veprimit që do të vazhdojnë punën e tyre këtu pasi ne të kemi shkuar. Shkolla Policore e Kosovës. Ombudspersoni. Instituti Gygësor i Kosovës, Qendra Burimore për Mbrojtjen Penale, Qendra Juridike e Kosovës, Qendrat e Komuniteteve dhe Qendrat e OJQ-ve, Radio-Televizioni i Kosovës, Komisioni i Pavarur për Media. Komisioni Qendror për Zgjedhjet dhe Sekretariati i tij. Përgjegjësitë e disa prej këtyre institucioneve tashmë pothuajse janë transferuar, ndërsa të tjerat do të transferohen më vonë. Të dashur lexues, siç po e shihni në artikuj të ndryshëm mbi programe të ndryshme të udhëhequra nga departamentet e misionit tonë, në vitin 2004 OSBE-ja në pajtim me rolin e ndërtimit të saj institucional do t'u japë më shumë përgjegjësi në shumë fusha zyrtarëve vendor. Në fund të vitit ne shpresojmë të jemi një hap më afër qëllimit të një Kosove demokratike të qëndrueshme.

Shpend Marsi



## DETAILS

Gazetë e publikuar nga OSBE-ja

Rruga Beogradi 32 38000 Pristina  
Tel. (+381-38) 500 162 Fax: (+381-38) 500 188  
E-mail: [press@omik.org](mailto:press@omik.org)

Botuesi:

Sven Lindholm

Kryeredaktorë:

Arni Snaevarr

Redaktorë:

Hasan Sopa (Detaje) Slavisa Mladenovic (Detalji)

Disenji & faqosja

Shpend Kada

Bashkëpunëtorët:

Arben Hajredinaj, Franklin De Vrieze,  
Lizabeta Paloka, Mustafa Eric,  
Olivera Stojanovic, Valentin Mitev

**osce**

Mission in Kosovo

Shënim:

Pikëpamjet e paraqitura apo prezantimi i materialeve të botuara nuk shprehin politikën, opinionet apo qëndrimet e misionit të OSBE-së në Kosovë.

vijon nga faqja 1

## Kosova - Parajsë për pirateri!

Mosrespektimi i të drejtave autoriale është fatkeqësisht shumë i përhapur në Kosovë. Ka qindra CD dyqane nëpër tërë Kosovën që shesin DVD filma, muzikë dhe programe për kompjuterë. Tash për tash, Kosova konsiderohet të jetë një treg i rëndësishëm për pronën e piratuar intelektuale. Është e ditur se vendet e zhvilluara dhe demokratike kanë ligje të rrepta që i mbrojnë patentet dhe pronën intelektuale të individëve apo kompanive. Katër vjet pas konfliktit, Kosova ende s'ka një ligj të mirëfilltë për mbrojtjen e të drejtave autoriale dhe pronës intelektuale. Një ligj mbi të drejtat autoriale është duke u hartuar nga Agjencia e Autorëve dhe pritet që të kalojë në Kuvendin e Kosovës në mars.

Përkundër kësaj situatë, shumë njerëz thonë se është gabim të keqpërdoret prona e tjetërkujt pa kompensim të rregulluar ligjërisht, ndërsa shumë e keqpërdorin këtë situatë si pasojë e mungesës së një ligji që do ta instalonte kompensimin e mirëfilltë të pronës intelektuale.

Interneti gjithashtu kontribuon për zhvillimin e piraterisë në Kosovë. Me miliona faqe që u mundësojnë shfrytëzuesve shkarkimin e filmave, muzikës dhe programeve tjera kompjuterike, kanë kontribuar në zhvillimin e piraterisë gjatë katër viteve të fundit.

## Agjencia e Autorëve

"Ekzistojnë dy gjëra fundamentale - të drejtat autoriale dhe kodi i mirësjelljes për media", thotë znj. Luljeta Bajčinovci, udhëheqëse e Agjencisë së Autorëve në Prishtinë. Ajo tha se shumica e medimeve kosovare keqpërdorin situatën e paligjshme duke mos respektuar të drejtat e autorëve jo vetëm në emetimin e filmave por edhe në transmetimin e muzikës e cila përbën diku rreth 70-80 për qind të skemave të tyre programore. Znj. Bajčinovci tha se ish ligji federativ jugosllav për të drejtat autoriale është ende i aplikueshëm në Kosovë dhe që secili rast trajtohet përbrenda obligimeve të caktuara nga ky ligj i stërvjetruar nga 1989. Ajo tha se ligji i ri duhet të bazohet në standarde moderne europiane të ligjeve mbi të drejtat autoriale.

Edhe kompanitë publike si PTK-ja (Posta dhe

Telekomi i Kosovës) nuk i respektojnë të drejtat autoriale. PTK-ja është kritikuar për shfrytëzimin e një fotografie të një fotografi të mirënjohur kosovar pa pëlqimin e tij dhe pa kurrfarë kompensimi, duke e vendosur atë në kartelatë gërrithëse dhe duke i shitur ato në qindra e mijëra për përfitim komercial. PTK-ja ishte hedhur në gjyq, por që tani e dy vjet procesi tërhiqet zvarrë për shkak të procedurave të ngadalshme gjyqësore. Znj. Bajčinovci tha se draft ligji i ri është duke u përkthyer dhe së shpejti do të kalojë nëpër një debat publik që më tutje të procesohet nëpër Ministrinë e Kulturës për në Kuvendin e Kosovës për miratim. Ajo gjithashtu shprehu brengat e saj rreth modifikimeve të draft ligjit nga joekspertë në grupet parlamentare të Kuvendit të Kosovës. Ajo tha se në ligjet e kaluara që kanë të bëjnë me çështje kulturore ishin shtrembëruar aq shumë nga grupet punuese të Kuvendit, sa që Agjencia e Autorëve nuk ishte në gjendje t'i njohë draftet e tyre. Znj. Bajčinovci tha se menjëherë pasi që ky ligj të miratohet dhe publikohet do të ketë ndikim gjithëpërfshirës në film, muzikë, literaturë dhe kategori që janë kopjuar dhe shndërruar në pirateri. Aq më shumë, ky ligj do t'i vë në lëvizje autoritetet kompetente të marrin masa ligjore kundër përdhunuesve të të drejtave autoriale. Agjencia e autorëve ka bashkëpunim konstant me agjenci tjera të autorëve në vendet fqinje duke i vënë theks të posaqëm Kroacisë dhe Sllovenisë si partnerë më relevantë në Ballkan.

Komisioneri i paruarur për media z. Robert Gillette, tha se nuk parashihet që ligji i ri do të ndikojë në mbylljen e shumë transmetuesve kosovarë. Transmetuesit mund të bashkëpunojnë dhe të blejnë filma apo blloqe të programeve tjera të cilat do të siguronin më shumë stabilitet për zhvillimet e ardhshme në fushën e të drejtave autoriale.

## Njerëzit

Një CD shitës afër qendrës kryesore të UNMIK-ut në Prishtinë, i cili s'deshi të identifikohet, thotë se shitja e mallit të piratuar është biznes i mirë për të, dhe se nuk ka ndonjë qëllim të ndërpresë shitjen e DVD filmave dhe programeve tjera për vetëm 2,5 Euro. "Pirateria ekziston gati gjithkund në vendet fqinje. Shumica e filmave në CD-ROM që kushdo mund t'i blejë në rrugë janë të 'importuar' nga Serbia, Mali i Zi, Rumania dhe Bullgaria", thotë ai. Përkundër ligjeve ekzistuese mbi të drejtat autoriale, thotë ai, këto shtete ende riprodhojnë DVD filma dhe i eksportojnë në vende të tilla siç është Kosova. Ai gjithashtu tha se nuk frikësohet prej ndonjë ligji të ardhshëm mbi të drejtat autoriale, pasi që edhe qeveria lokale ishte e zhytur thellë në këtë biznes.

Aq më shumë, ai shtoi se shumica e CD shitësve ishin më shumë të preokupuar me efektin e dëmshëm që u bëjnë televizionet lokale në biznesin e tyre duke transmetuar filma piratë se sa ligjet e reja.

Biznesi po lulëzon ndërsa bashkëbiseduesi i Detajeve thekson se nuk është rastësi që shumica e CD dyqaneve ndodhen pikërisht në të ashtuquajturën rrugë e policisë në Prishtinë, afër organizatave ndërkombëtare, anëtarët e të cilave janë edhe myshterinj të më frekuentues.



Njëri nga qoshet e shumta të shitjes së CD-ve pirat në rrugët kryesore të Prishtinës

# Toleranca ndëretnike me ngjarje kulturore

Drejtori i shtëpisë së kulturës në Shtërpcë, z. Ljubisha Raqiçević, ishte ndër bashkëpunorët e parë që mbështeti aktivitetet kulturore me karakter ndëretnik në mes të shqiptarëve dhe serbëve të kësaj komune.

nga Hasan Sopa

Edhe pse ekzistojnë lidhjet historike dhe kulturore, shqiptarët dhe serbët e Kosovës nuk ishin në gjendje të rivendosin normat e barazisë shoqërore dhe ta zhvillojnë tolerancën ndëretnike. Shtëpia e kulturës 'Sveti Sava' i'u drejtua zyrës së OSBE-së në Shtërpcë, me idenë për

mbështetje afatgjaste të një iniciative për ndërtimin e një klime tolerante dhe zhvillimit të një shoqërie shumëetnike, veçanërisht në sferat jopolitike.

Nën drejtimin departamentit për demokracizim të OSBE-së dhe mbështetje të plotë të drejtorit të departamentit për arsimit, z. Sule-

jman Selmani nga fshati Firajë, shtëpia e kulturës 'Sveti Sava' organizoi dy ngjarje kulturore, vallëzim dhe prezantime kulturore, në një fshat të Shtërpcës të banuar kryesisht me shqiptarë të Kosovës. Ngjarje të tilla kulturore do të organizohen edhe në të ardhmen me qëllim të promovimit të tolerancës ndëretnike.

**OSBE: prioritetet për vitin 2004:**

Më tepër përgjegjësi për vendorët në organizimin e zgjedhjeve


## OSBE-ja mbetet përgjegjëse për çështjet e ndieshme

“Do të ketë ndryshime të rëndësishme në zgjedhjet e këtij viti pasi që OSBE-ja ka filluar t’ia transferojë përgjegjësi të caktuara ‘Sekretariatit të Komisionit Qëndror Zgjedhor’, i themeluar rishtazi”, tha Lars Lagergren, drejtor i departamentit të zgjedhjeve. Gjatë viteve të kaluara, OSBE-ja ka qenë përgjegjëse për organizimin e zgjedhjeve të lira, të ndershme dhe demokratike në Kosovë, por tani ka ardhur koha të ngriten kadro vendore për të organizuar zgjedhjet.

“Do të ketë transferim nga stafi i OSBE-së tek nëpunësit civil. Sekretariati i KQZ-së do të jetë përgjegjës për planifikim në nivelin qëndror, dhe së bashku me komisionet komunale zgjedhore, do të marr përsipër detyrat operative që duhet të implementohen në nivelin vendor,” thotë zyrtari i OSBE-së Lars Lagergren.

Departamenti i zgjedhjeve pranë OSBE-së, megjithatë, nuk do të largohet tërësisht. Ky departamenti do ta këshillojë ‘Sekretariatit’ dhe do të mbajë përgjegjësi për aktivitete të caktuara. Do të jetë përgjegjës për përgatitjen e listës së votuesve, version të modifikuar të progamit për votues jashtë Kosovës, planifikim dhe organizim të qendrës për numrim dhe rezultate. Do të jetë edhe një organ për ankesa, i cili do të mirret me ankesat që kanë të bëjnë me përgatitjen e zgjedhjeve dhe aktivitetet e zhvilluara në ditën e zgjedhjeve.

A.S.



# Liria e të shprehurit kundruall përgjegjesisë ndaj opinionit

A mund të mbijetojnë 120 Radio dhe TV në Kosovë?

nga Mustafa Eric

Në mes tjerash, koncepti i demokracisë i referohet lirisë së njerëzve që të dëgjojnë një shumë zëra. Në çdo shoqëri që është në tranzicion dhe e cila ka kaluar nga totalitarizmi në demokraci pluraliste, liria e mediave ka qenë një nga standardet themelore të promovuara nga organizatat ndërkombëtare si dhe nga qeveritë dhe agjencitë sponsorizuese. Kosova nuk bënë përshkrim këtu.

Që nga mbarimi i konfliktit të armatosur dhe prej kohës kur u vendosën Kombet e Bashkuara në Kosovë në vitin 1999, një rritje e vazhdueshme e mediave elektronike është shënuar duke iu falemnderuar dy faktorëve: progresit teknologjik dhe zemërgjerësisë së donatorëve. Faktori i parë e ka mundësuar themelimin e një radioje apo televizionit me një qmim relativisht jo të shtrenjtë dhe i dyti u ka mundësuar shumë njerëzve të menqur por të papunë që të kërkojnë mundësi për përfitime financiare në biznesin e mediave pa marrë parasysh aftësitë apo përgatitjen e tyre profesionale për funksionimin e atyre medimeve. Le t’i shtojmë kësaj edhe mënyrën e lehtë për të marrur licencën prej Komisionerit të Përkohshëm për Media dhe do të keni situatën aktuale në duar: më shumë se 120 radio lokale dhe TV stacione në tërë territorin e Kosovës me një standardizim apo kualitet të ultë profesional.

### Një publik prej 15.000 njerëzish

Pjesa dërmuese e këtyre stacioneve i drejtohen një publiku prej afro 15.000 njerëzish me një vlerësim optimist. Ky nuk është një treg mjaft i madh për të përkrahur aktivitetet e një mediami elektronik nëse ai bazohet vetëm në të hyrat që të fitohen nga reklamimi që vjen nga popullata lokale. Kjo pengesë e dukshme i ka shtyrë menagjerët apo operatorët e stacioneve që të bëjnë një klasifikim ekstrem, i cili qartazi ka pak lidhje me konceptin adekuat transmetues: TV Mitrovica bënë inçizimin e dasmave dhe i transmeton ato si “programe” me një pagesë prej 100 Euro.

Natyrisht, dikush mund të thotë se ato stacione të cilat i zgjedhin mënyrat “kreative” për mbledhjen e fondeve për të mbështetur aktivitetet e vet munden apo duhet që të konsiderohen si të “pafajshme”. Fundi i fundit, ato janë “biznese private” dhe përderisa ato “nuk e shkelin ligjin” duhet të jenë të lira që të fitojnë nga çdo burim ligjor. Por nuk është aq thjeshtë: kompanitë e transportit urban, taksit apo minibusat që janë duke operuar, duhet që të veprojnë sipas rregullave të caktuara. Ata nuk mund të punësojnë vozitës që nuk kanë patent shoferit, nuk mund të përdorin automjete të cilat nuk janë në gjendje të rregullt, nuk mund të marrin më shumë udhëtar se sa që parashihet në

rregullore. Edhe pse i udhëhequr nga sipërmarrës privat, trafiku urban është një shërbim publik dhe standarde minimale duhet që të përshatën për kryerjen e kësaj pune duhet.



### Duke e pritur KPM-në

Për nga natyra, transmetimi është një shërbim publik pa marr parasyshë statutin e pronësisë së mjeteve që i dërgojnë sinjalet në frekuenca të cilat pranohen nga aparatet televizive apo radiot e popullit. Dhe, në një ambient ku shumësia e sinjaleve të tilla shkakton pengesa në frekuencat e transmetuesit tjetër duket se ka ardhur koha për rishkrimin e rregullave dhe rregulloreve në të mirë të publikut. Tani, shumë akcionar janë duke pritur miratimin e parë dhe pastaj nxjerrjen e ligjit të stërvonuar për krijimin e zyrës së Komisionerit të Pavarur për Media (KPM). Menjëherë pas kësaj do të vendoset skena për prezentimin dhe përforcimin e rregulloreve të cilat do të sigurojnë realizimin e standardeve adekuate për transmetim në Kosovë.

Është e pranuar botërisht se kontrollimi i mediave prej dhe brenda mediave është një opcion shumë më e mirë kur krahasohet me alternativat e tjera, siç janë kontrollimi nga interesat financiare ose ndikimet partiake apo qeveritë. Megjithatë, duhet të pajtohemi se përveç disa përjashtimeve, themelimi i mediave në Kosovë ka një rrugë të gjatë deri sa të arrij pjekurinë dhe të jetë i aftë për të ushtruar një vetë-kontroll profesional dhe etik. Përderisa nuk arrihet kjo, kontrolli rregullues i mediave në Kosovë (KPM) do të duhet që të mbetet një mekanizëm i domosdoshëm për t’u siguruar se ky shërbim publik i shërben me të vërtetë publikut.

# Kur vendorët marrin përgjegjësinë

OSBE-ja u dorëzon Qendrat e Komunitetit OJQ-ve vendore në 8 komuna

nga Arni Snaevarr

Një gjel këndon me krenari në shkallët e qendrës së komunitetit të fshatit Ropotovë e Madhe dhe përshëndet vizitorët, për t'i përkujtuar ata se gjinden në komunitetin rural të Kamenicës, komunës më lindore të Kosovës, e cila kufizohet me Serbinë. Qendra e komunitetit i shërben enklavës serbe, e cila përbëhet prej 15 fshatrave, me përafërsisht 8,000 banorë. OSBE-ja ka themeluar qendrën e komunitetit në vitin 2001, por tani është koha që aktivitetet t'u dorëzohen vendorëve. Tre anëtarët e stafit kanë krijuar një OJQ me shumë anëtarë tjerë për të vazhduar detyrën që OSBE-ja kshihte marrë përsipër tri vite më parë.

"Qendra e komunitetit është shumë e rëndësishme për popullatën e këtushme," tha bashkëmenaxheri Ivan Kërstiq. "Shpresojmë ta bëjmë të qëndrueshme dhe të vazhdojë punën edhe pas dorëzimit. Një marrëveshje e mirëkuptimit në mes të OJQ-së dhe OSBE-së pritet të nënshkruhet gjatë javëve të ardhshme.

Kjo qendër është pjesë e një rrjeti të qendrave të komunitetit dhe qendrave burimore të OJQ-ve, krijuar nga OSBE-ja. Në përgjithsi, qëllimi i kësaj qendre është të punohet me shoqërinë civile me qëllim të përmirësimit të kapaciteteve të qytetarëve të Kosovës për të kontrolluar institucionet e tyre. Kjo arrihet përmes qytetarëve më mirë të informuar, pjesëmarrjes së shtuar të qytetarëve në bërjen e politikave, si dhe me një qeverisje lokale dhe qëndrore më të përgjegjshme dhe më transparente. OSBE-ja ka krijuar qendrat burimore të OJQ-ve në 5 komuna, kurse qendra të komuniteteve në 8 komuna tjera për të përkrahur sektorin e shoqërisë civile. Qendrat burimore tashmë i janë dorëzuar OJQ-ve vendore kurse këtë vit, OSBE-ja do t'ua dorëzojë atyre edhe 5 qendra të komunitetit, përveq atyre funksionimi i të cilave tashmë është marrë përsipër nga vendorët.

Qendrat e komunitetit në Shtërpce dhe Leposaviq tashmë u janë dorëzuar OJQ-ve vendore, derisa ato në Ropotovë, Dragash, Zubin Potok, Mitrovicë veriore dhe Fushë Kosovë kanë filluar këtë proces.

"Qendrat e komunitetit gjatë vitit 2004 do të financohen pjesërisht nga OSBE-ja," thotë Bujar Maxhuni nga OSBE-ja. "Strategjia jonë është t'i kemi të gjitha qendrat tërësisht të pavarura dhe të qëndrueshme."

Ndonëse qendrat e komunitetit kanë të njëjtin qëllim sikur edhe qendrat burimore të OJQ-ve, ato i shërbejnë komunitetit në rajonet përkatëse dhe adresojnë edhe brengat e banorëve të tyre. Qendrat e komunitetit përpiqen t'i ndihmojnë popullatës lokale duke adresuar vështirësitë në qasjen në qeveritë lokale or institucionet tjera.

Kjo është e vërtetë edhe për qendrën e komunitetit të Ropotovës së Madhe. "Ne ofrojmë

shërbime të thjeshta, elementare por shumë të rëndësishme," thotë bashkë-menaxhuesja Katarina Ristiq. Qendra e komunitetit ka marrë iniciativë për të krijuar një rrjetë të udhëheqësve të fshatit. Udhëheqësit e fshatrave në këtë rajon takohen çdo muaj, nganjëherë edhe me liderët komunal me qëllim që ta ofrojnë komunitetin më shumë me strukturat komunale. "Ne mundohemi t'i lidhim njerëzit e thjeshtë me përfaqësuesit e tyre në komunë dhe anasjelltas, përfaqësuesit me elektoratin e tyre," tha Daiana Falloni, nga departamenti për demokratizim pranë OSBE-së. Qendra e komunitetit shërben si një qendër informimi për komunitetin, ndihmon dhe udhëzon banorët të gjejnë shërbimet që janë në dispozicion. Një gazetë mujore e botuar nga qendra për komunitet është një mjet i rëndësishëm në përpjekje për ta informuar popullatën vendore. Aktivitetet e qendrës variojnë nga ofrimi i trajnimit për bujqësi deri te kurset për kompjuter.

"Ne japim informata të sakta, gjë që është me rëndësi duke marrë parasysh thashethemet që qarkullojnë në një komunitet të tillë," thotë Ivan Kërstiq.

Fëmijët nuk janë harruar: Derisa 'Detajet' ishin në vizitë, fëmijët kalonin kohën duke shikuar Hari Poterin në video! Më të moshuarve u është siguruar qasje në kompjuter, me shpresë se qasja në internet do të pasojë. Çfarë gjasja ka një qendër e komunitetit në një lokalitet kaq të vogël të bëhet e qëndrueshme? Qendra do të mund të kërkojë donatorë tjerë kur të jetë pavarësuar nga OSBE-ja. Por ka edhe mundësi

tjera. "Një 'Internet Caffe' është një opcion," thekson Katarina Ristiq.

"Ekzistojnë disa mundësi që qendrat të bëhen të qëndrueshme dhe të marrin të ardhura për të mbuluar shpenzimet e tyre," thotë Bujar Maxhuni nga OSBE-ja. "Disa qendra tashmë kanë arritur të hapin 'Internet Caffe-et' e tyre dhe janë shumë të sukseshme në ofrimin e shërbimeve të rrjetit." Por linjat e telefonisë fikse nuk janë gjithmonë të besueshme, prandaj qendra për komunitet ka hasur në pengesa derisa ka provuar të marrë shërbime më të mira telefonike. Sikur që është rasti me shumë eklava serbe në Kosovë, ajo gjindet në mes dy zjarreve, duke mos ditur kujt t'i drejtohet kur kanë vështërsi për të siguruar shërbime komunale. Nëse shërbimet nga ofruesit serb janë më të mira ose më të besueshme se ato kosovare, atëherë është gjithmonë më joshëse të preferohet e para. Por 'Interneti' nuk është zgjidhja e vetme. "Duke ofruar trajnime dhe duke u bërë pikë kontakti ose ndërlihdhjeje në mes të komuniteteve të tyre dhe palëve tjera të interesuara, si p.sh. qeverisë lokale dhe qëndrore, OJQ-ve, ata mund të kërkojnë pagesë për shërbimet që ata ofrojnë," thotë Bujar Maxhuni nga OSBE-ja. Bashkëmenaxhuesit pranojnë se 'plani i madh' është të marrin një certifikim për 'Qendër Trajnuese Profesionale' nga Ministria e Punës dhe Mirëqenjes Sociale për të ngritur shkathhtësitë e njerëzve që kanë shkollim elementar. Tashmë janë mbajtur edhe mbledhje me ministrinë, e cila ka mirëpritur këtë iniciativë, duke potencuar interesin e saj të shtuar për komunitetet pakica.



Njëri nga takimet e rrjetit udhëheqës të fshatrave, mbajtur çdo muaj në qendrën e komunitetit në Ropotovë

# Sistemi Gjyqësor i Kosovës

"E ardhmja e sistemit gjyqësor të Kosovës është në duart e gjeneratave të reja. Zotërimi i gjuhëve të huaja u mundëson atyre një qasje më të lehtë në sferat e studimit - thotë Kryetari i gjykatës supreme të Kosovës", z. Rexhep Haxhimusa

Intervistoi: Hasan Sopa

Në kohën kur UNMIK-u vuri pushtetin në Kosovë, pesë vite më parë, njëra nga detyrat kryesore të faktorit ndërkombëtar ka qenë bashkëpunimi me komuniteti vendor për vënjen në funksion të një sistemi gjyqësor, që do të ishte në shërbim të të gjithëve. Natyrisht, kjo nuk ishte një detyrë e lehtë për t'u bërë por ishte më se e domosdoshme. Në perudhën mes qershorit dhe shtatorit të vitit 1999 u bë themelimi i një sistemi gjyqësor emergjent, por që nga ajo kohë në sistemin gjyqësor të Kosovës janë bërë përparime të dukshme.

## Aplikohet parimi i akuzatorit

Njëra nga ndryshimet thelbësore është nxerrja e Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale, nga Përfaqësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombëve të Bashkuara. Tani çështja është se si do të filloj aplikimi i tyre meqë të dyja këto përmbajnë shumë risi. Z. Rexhep Haxhimusa, kryetar i gjykatës supreme të Kosovës vlerëson se në krahasim me regjionin e evropës juglindore, në Kosovë është bërë një hap shumë kurajoz në pikpamje të ndërtimit të legjislativit i cili është koherent me ligjislativ të shteteve perendimore. Ai mendon se sistemi ynë gjyqësor hynë në radhën e atyre sistemeve ku sundon parimi i akuzatorit. "Kjo nënkupton se palët në procedurë janë të barabarta, d.m.th paditësi apo prokurori është i barabartë me palën mbrojtëse dhe të akuzuarin, ndërsa gjykata ka rolin absolut të arbitërit" shpjegon z. Haxhimusa. Mandej, format e ndryshme siq është forma e vëzhgimit të personave të cilët merren me veprimtari kriminale, dëshmitarët e ndryshëm, dëshmitari bashkëpunëtorë, anonim dhe i mbrojtur avansojnë mundësinë e luftimi të kriminalitetit shumë më me sukses se sa deri më tani.

## Kushtet e punës dhe pozita e gjykatësit

Sistemi gjyqësor i Kosovës pas vitit 1999 mund të konsiderohet si një sistem i ri, jo për nga struktura e kuadrove, por si organizim. "Edhe pse pjesërisht bazën e kemi në ligjet e të së kaluarës, ato kryesisht janë ligje të cilat në vete mbërthejnë pjesën më të madhe të konventave ndërkombëtare që kanë të bëjnë me të drejtat dhe liritë e njeriut në të gjitha fushat", thotë z. Haxhimusa. Prandaj, konsideroj se në këtë periudhë ne kemi bërë një hap shumë të madh dhe të sigurt, ku po ndërtojmë një sistem gjyqësor në të cilin shoqëria duhet të ketë besim. Jo besim apriori, por një besim të verifikuar në zbatimin e ligjeve me një profesionalizëm të lartë".

Meqë Kosova është duke kaluar nëpër një fazë të vështirë tranzicioni, kjo domosdo përcakton edhe kushtet dhe pozitën e gjyqësorit. Z. Hax-



### Biografia

Rexhep Haxhimusa pas mbarimit të drejtësisë në vitin 1966, pothuaj menjëherë ka filluar punën si zvendës prokuror në gjykatës komunale të Ferizajt dhe një kohë ka qenë edhe kryetar i saj. Në vitin 1979 është zgjedhur gjyqtar në gjykatën supreme në Prishtinë, ku ka punuar deri në vitin 1982. Pastaj është kthyer prap në Ferizaj dhe ka punur si kryetar i kuvendit komunal të atëhershëm dhe kryetar i këshillit ekzekutiv. Pas një vit mosangazhimi, ka filluar të punoj si avokat dhe për 10 vite është marrë kryesisht me çështje penale. Si avokat ka qenë i njohur për angazhimin tij me të ashtuquajturat procese politike. Menjëherë pas konfliktit, ka filluar të punoj në gjykatën supreme dhe që nga vitin 2000 është kryetar i kësaj gjykate

himusa mendon se gjyqësia ka rol vendimtar në vendosjen e themeleve të të tri pushteteve, që janë në interes të qytetarëve. Ai gjithashtu mendon se të ardhurat profesionale, mandati, pozita në shoqëri dhe siguria e gjyqëtarit e përcaktojnë ndoshta edhe motivin e tij për punë. Megjithatë, kjo nuk ka ndikuar dhe nuk duhet të ndikoj në angazhimin e tyre në ndërtimin e një sistemi të mirëfillt gjyqësor.

Sa i përket pozitës së gjyqëtarit, ai mendon se parasegjitash gjyqtari duhet të veproj i pavarur i paanshëm dhe i pandikuar në vendmarrje dhe zbatim të ligjit.

## Kodi Penal dhe Kodi i Procedurës Penale

Sipas z. Haxhimusa sistemi juridik i një shteti varet nga ligjet që ka dhe se sa ato ligje reflektojnë raportet shoqërore mbi të cilat pretendon të ndërtoj veten si shoqëri. "Mendoj se një numër i ligjeve që janë të aplikueshme i përmbushin standardet, për derisa ato nuk janë diskriminuese dhe jashtë standardeve ndërkombëtare" thotë z. Haxhimusa. "Me nxerrjen e ligjeve penale si Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale, mendoj se është bërë një hap i madh përpara. Gjithashtu, përgaditjet që po bëhem për nxirrjen e Kodit Civile dhe Rregullore mbi pronën dhe transformimin e pronës, si dhe ligjet tjera që e ndërtojnë fushën e së Drejtës Civile bashkë me të Drejtën Administrative, teçojnë se jemi në fund të fazës të ashtuquajtur të përkohshme të ligjeve".

## Ligjet të kenë pika të përbashkëta në kuadër të një regjioni

Ekziston një tendencë e zhvillimit të legjislativit të evropës juglindore, në mënyrë që të kenë pika të përbashkëta në kuadër të një regjioni. "Nëse protodohet në integrimet e ndryshme evropiane, është e domosdoshme që legjislativi të përmbush standardet të cilat janë përcaktuar nga shtetet në zhvillim, e që kanë një përvojë në këtë drejtim. Pra këtu mendoj në një legjislativ që mundëson zhvillimin ekonomik, lëvizjen e lirë të kapitalit dhe fuqisë punëtore, të drejtën e punës dhe pronës private, bashkë me mënyrat e organizimit të ekonomisë dhe ushtrimit të pushtetit" shpjegon në vazhdim z. Haxhimusa.

Sipas tij së shpejti do të formohet një grup ekspertësh që do të merret me zhvillimin dhe strukturimin e sistemit gjyqësor. Ai thekson se është mëse e nevojshme të shfrytëzohet përvoja e eksperteve ndërkombëtar të UNMIK-ut, OSBE-së dhe organizimave të tjerë që punojnë dhe veprojnë këtu, sepse ndihma e tyre është e mëse e nevojshme

## Duhen bërë reforma

Pjesa e sundimit të ligjit që ka të bëjë me Drejtësinë, është fushë e rezervuar e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm OKB-së. "Mendoj se disa reforma në administrim dhe menagjim të sistemit gjyqësor janë të domosdoshme. Kështu si është shpeshherë ka moskuptime dhe paqartësi edhe pse deri më tani nuk janë reflektuar në aspektin e funksionimit të gjyqësis, por mund të kenë pasoja për qytetarin apo subjektet tjera pjesëmarrëse

në procedura të caktuara", shprehet z. Hagjimusa.

"Ne jemi të vetëdijshëm se në një pjesë të Kosovës funksionon gjyqësori i Serbisë, që ka një procedurë të veçantë dhe nuk përkon me procedurën e aplikuar. Kjo gjithësesi dëmton dhe pengon organizimin dhe funksionimin e gjyqësisë si pushtet i veçantë, i ndarë nga pushteti legjislativ dhe ekzekutiv" thekson ai në vazhdim'.

Seria e trajnimeve që janë mbajtur këtu në Institutin Gjyqësor të Kosovës (IGJK) por edhe në

institute tjera, kanë ngritur nivelin e përgjithshëm profesional të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Z. Hagjimusa e kosideron Institutin Gjyqësor të Kosovës si një mekanizëm të ndërtimit të gjyqtarëve, përmes ligjerata dhe punëtorive të ndryshme. "Në numër i madh i tyre kanë patur fatin dhe janë dërguar në vende të ndryshme të Evropës dhe kjo për ne ka qenë një përvojë e pa zavadësueshme nga se është parë në praktikë se si duhet të punohet. Prandaj, perspektiva e Gjyqësisë Kosovare është në duart e gjeneratave të reja" përfundon z. Hagjimusa.

## OSBE: prioritetet për vitin 2004:

# Demokratizimi në kohën e standardeve

"Qëllimi ynë është të mbështesim zhvillimin e institucioneve që të funksionojnë në mënyrë efikase dhe demokratike në nivelin qendror dhe vendor përmes përpjekjeve për ngritjen e kuadrove profesionale që sigurojnë legjislacionin në fuqi dhe ofrimin e shërbimeve publike" thotë Johan de Velde, kryesuesi i ri i departamentit për demokratizim të OSBE-së, për sfidat që gjenden përpara, gjatë këtij viti, në fushën e këtij departamenti.

"Qëllimi tjetër është rritja e pjesëmarrjes së qytetarëve në procesit e marrjes së vendimeve dhe i bënë organet qeveritare të përgjegjshme për çështjet e qytetarëve. Përfundimisht duke mbështetur nevojën e krijimit të institucioneve profesionale dhe të përgjegjshme për medime."

nga Arni Snaevarr

## Puna me qeveri qëndrore dhe vendore

Ti shikojmë më për së afërmi prioritetet e programit të Demokratizimit. Në nivelin e qeverisë qëndrore, OSBE-ja koordinon asistencë për Kuvendin e Kosovës dhe punon në nivele partiake për të përmirësuar punën e anëtarëve të Kuvendit dhe komisioneve. Njësia monitoruese e OSBE-së për Kuvendin e Kosovës do të vazhdojë punën e saj në pajtim me dispozitat e kornizës kushtetuese. OSBE-ja do të vazhdojë të ofrojë mbështetje për shërbimet civile përmes ngritjes së kuadrove profesionale me 'Institutin e Kosovës për Administratë Publike' (IKAP).

Objektivi i OSBE-së është që t'iu ofruar mbështetje të drejtëpërdrejtë Institucioneve të Përkohshme Vet-qeverisëse (IPVQ). Këshilltarët e OSBE-së bashkëpunojnë në ngritjen e kuadrove në zyrat këshillëdhënëse duke punuar me kryeministrin dhe ministritë përkatëse. Këto zyre këshillëdhënëse mbikëqyrin praktikën qeveritare të ministrive, shqyrtojnë projekt ligjet, dhe zhvillojnë udhëzime për implementim në fushën e qeverisjes së mirë, të drejtave të njeriut, ofrimin të mundësive të barabarta, barazia gjinore, dhe çështjen e komuniteteve.

Programet vendore qeveritare koordinojnë asistencë për kuvendet dhe punojnë me ta për të ofruar trajnime dhe këshilla praktike. Vitin e kaluar ne kemi trajnuar gati 2,500 anëtarë të Kuvendit të Kosovës në të gjitha komunat e Kosovës. Kjo gjithashtu punon me 'Asociacionin e Komunave të Kosovës' (KTA), për të ngritur një komponent institucional për të gjitha programet e trajnimit të ofruara gjer më tani.

## Pjesëmarrja qytetare

Krah për krahu me programet qeveritare duke punuar në të dyja nivelet, atë qëndrore dhe vendore, është puna jonë me shoqërinë civile,

e cila ka qëllim të përmirësojë kapacitetin e qytetarëve të Kosovës për të mbajtur institucionet e tyre në kontrollë. Kjo bëhet përmes ngritjes së vetëdijes mes qytetarëve, duke rritur pjesëmarrjen e qytetarëve në politikën e opinionit publik, dhe duke bërë qeverinë vendore dhe qëndrore më të përgjegjshme dhe transparente. OSBE-ja ka formuar qendra burimore të OJQ-ve në 5 komuna dhe në 8 qendra të komuniteteve për mbështetje të sektorit shoqëror. Të gjitha qendrat burimore tashmë u janë dorëzuar OJQ-ve vendore dhe këtë vit OSBE-ja do t'iu dorëzojë OJQ-ve vendore udhëheqjen e 5 qendrave të komuniteteve përveç dy qendrave funksioni i të cilave tashmë iu është dorëzuar akterëve vendor.

## Më shumë përgjegjësi për vendorët në mbikëqyrjen e mediave

Një nga qëllimet kryesore të misionit është të

krijojë kushte të përshtatshme për zhvillim të mediave të lira profesionale dhe të përgjegjshme. Në vitin 2004 OSBE-ja do të bëjë transferimin e aktiviteteve për trajnim të mediave në institucionet vendore. OSBE-ja në bashkëpunim me 'Komisionerin e Përkohshëm për Media' dhe bashkëpunorët vendor punojnë për themelimin e 'Këshillit për Shtyp në Kosovë', për të funksionuar si një organ kryesor vet-rregullues për mediat e shtypura. Përmes kodit të mirësjelljes, këshilli do të synojë të përkrahë standardet evropiane të etikës dhe profesionalizmit në mediat e shtypura. Shprehet se këtë vit do të miratohet legjislacioni përkatës dhe një institucion vendor 'Komisioni i Pavarur për Media' do të pranojë përgjegjësitë e 'Komisionerin e Përkohshëm për Media', i cili do të shërbejë si një agjencion rregullues për medime dhe gjithashtu i ka pranuar përgjegjësitë e një regjimi të përkohshëm për licënsim.



# Të mësojmë nga njëri tjetri

Prej 15 deri me 19 dhjetor, udhëheqësit kryesorë politikë të Kosovës u takuan me negociatorët dhe vendimarrës kryesorë nga vendet e ndryshme të botës për të diskutuar mënyrën e udhëheqjes dhe negociatat. Vendi ku u takuan ishte kështjella piktoreske 'Burg Shlaining' në Austri, ku u bë një shkëmbim intensiv i përvojave me pjesëmarrës nga Irlanda Veriore, Republika e Irlandës, Izraeli, Palestina, Afrika Jugore dhe Kili.

nga Franklin De Vrieze

Por, çfarë kanë të përbashkët këto vende me Kosovën? Ku dallojnë ato? Një reagimi i menjëhershëm mund ti vë në pah dallimet gjeografike, historike dhe politike. Por, vetëm pas një reflektimi fillojnë të shfaqen gjëra të përbashkëta.

Çfarë kanë të përbashkët këto vende dhe rajone është një histori e gjatë dhe e përgjakshme e konflikteve etnike apo politike me disa aspekte religjioze. Kjo është e vërtetë, posaçërisht kur ka të bëjë me fatin e njerëzve të tyre, fat i cili shpesh karakterizohet me mungesën e tërësishtme të drejtave themelore njerëzore, politike, ekonomike, varfëri sociale dhe mohim të vlerave kulturore.

A ka ide më të mirë se sa t'i bashkosh përfaqësues nga këto rajone të prekura nga konfliktet, për t'i krahasuar botëkuptimet e tyre dhe për t'i dëgjuar ata të cilët kanë kaluar në situata të ngjashme, apo që ende janë në mes të një konflikt të thellë, siç është ai në mes të izraelitëve dhe palestinezëve. Apo të mësosh për këtë çështje, nga ata që me sukses kanë mposhtur aparteidin, si në rastin e Afrikës Jugore, ku të bardhët dhe zezakët zhvilluan betejën triumfale kundër racizmit.

Kjo konferencë ishte e një rëndësi të veçantë pasi që në të morën pjesë të pesë liderët kryesorë të Kosovës: kryetari Ibrahim Rugova, kryeministri Bajram Rexhepi, kryetari i Kuvendit Nexhat Daci, kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës Hashim Thaçi dhe kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ramush Haradinaj.

Derisa përfaqësuesit e komuniteteve turke, boshnjake dhe e ashkalive morën pjesë në këtë konferencë, serbët e Kosovës i refuzuan ftesat.

'Zhvillimi i strategjive për negociata' ishte tema e kësaj mbledhjeje tepër interesante, e cila më tepër kishte të bënte me çështjet teknike se si duhet përgatitur për negociata, si të ngriten aftësitë profesionale, si të krijohen marrëdhëniet punuese apo si të vepron me palë me interese të shumfishta në një proces negociator.

Përveq përfitimit të aftësive politike dhe diplomatike për ndërmejtësim në një marrëveshje politike, një përshtypje të fortë bën edhe historia personale e këtyre negociatorëve për paqe nga i tërë globi: David Ervini, aktivisti irlandez që kaloi dhjetë vite në burg dhe që më vonë ia përkushtoi jetën e tij paqes dhe pajtimit; Ismail Ebrahim Ebrahimi, nga Afrika e Jugut i cili kishte kaluar njëzet vite në burg bashkë me Nelson Mandelën dhe i cili vendosi të arrijë deri te ish-shpësit e tij në mënyrë që në vendin e tij të fitojë paqja dhe e drejta për çdokend; homologu i tij i bardhë nga Afrika e Jugut, i cili si zyrtar i regjimit aparteid vendosi t'i bashkojë forcat me shumicën e shtypur. Këta heronjë modern paraqitën dëshmi bindëse forcës së drejtësisë dhe lirisë njerëzore. Për Wolfgang Petritqin, Ambasadorin e Austrisë në Kombet e Bashkuara në Gjenevë, "fshehtësia e suksesit duket se është në mundësin e daljes nga akuzat e së kaluarës dhe pikëpamjeve përjashtuese".

Në sesionin përmbyllës të takimit, kryetari Ibrahim Rugova deklaroi se diskutimet ishin

stimuluese dhe të dobishme dhe konsideron këtë takim një sukses të madh. Z. Hashim Thaçi shtoi se Kosovës i duhet të fitojë besimin e bashkësisë ndërkombëtare dhe se shpreson se ky takim do të inicojë përpjekje të freskëta për kultivimin e marrëdhënieve të reja ndërkombëtare. Pas kthimit në Kosovë, profesor Nexhat Daci i bëri këto komente në shtypin e ditës: "Pjesëmarrja në këtë seminar kishte rëndësi të dyfishtë për ne. Përfitimi i parë ishte mësimi nga pjesëmarrësit e vendeve që kanë tejkaluar problemet dhe që kanë formuar shtetet e tyre siç është Afrika e Jugut dhe nga vendet siç është Irlanda ku ka leksione të rëndësishme për t'u mësuar. Përfitimi i dytë ishte se ne ishim të larguar për tri ditë nga problemet tona ditore dhe të gjithë liderët patën komunikim të shkëlqyeshëm". Dr. Friedhelm Frishensh-lager, drejtori i mëparshëm i departamentit për demokratizimin, misioni i OSBE-së në Kosovë pohoi: "Bota ka vuajtur nga këto probleme më parë dhe ende vuan. Dhe këta akterë që vijnë këtu me një përvojë të mëdha u kanë ilustruar liderëve politikë të Kosovës se ata duhet t'i shtrijnë dorën njëri tjetrit kur është e nevojshme të gjindet zgjidhja".

*Konferenca mbi 'Zhvillimin e strategjive për negociata' ishte e organizuar nga Universiteti i Haroardit dhe nga misioni i OSBE-së në Kosovë dhe poashtu ishte mbështetur nga Instituti për Hulumtime dhe Zhvillim të Politikave në Kosovë (KIPRED) dhe qendra ndërkombëtare 'Olof Palme' në Suedi. Disa udhëheqës ndërkombëtar, përfshirë edhe kryetarin e mëparshëm të SHBA-ve Bill Klintonin, përkrahën këtë iniciativë. Në mesin e zyrtarëve që morën pjesë në të ishin: Xhon Bieli, këshilltar i qeverisë së Kostarikës gjatë marrëveshjes së paqes në Amerikën Qendrore më 1987 dhe ish sekretari i përgjithshëm i kryesisë së Kilit.*

*Ismail Ebrahim Ebrahimi, këshilltar politik i zëvendëskryetarit të Afrikës së Jugut dhe pjesëmarrësi i lartë i kongresit kombëtar afrikan në negociatat shumëpalëshe në Afrikën Jugore*

*David Ervini, negociator i lartë në bisedat që shpion në 'Marrëveshjen e të Premtës së Mbarë' dhe zëdhënës kryesor i partisë sindikaliste progresive në Irlandën Veriore*

*Pini Meidani, këshilltar i mëparshëm për politikë të jashtme dhe negociator i lartë i kryeministrit të Izraelit Ehud Barak në vitin 2002 në bisedimet në Kamp David*

*Rolf Mejeri, negociator kryesor për qeverinë e mëparshme të De Klerkut dhe për ministrin e mëparshëm për çështje kushitetuese të Afrikës së Jugut*

*Albert Reynolds, kryeministri i mëparshëm i Republikës së Irlandës dhe pjesëmarrës kyç në procesin e paqes në Irlandën Veriore.*



Udhëheqësit Kosovar të fotografuar bashkarisht në Kalanë e Shlainingut në Austri



## Do të caktohen ekspertë të të drejtave të njeriut nëpër komuna dhe ministri

nga Arni Snaevarr

"Synimi i departamentit të të drejtave të njeriut për vitin 2004 është të zhvendos vëmendjen për të drejtat e njeriut nga kontrolli nga jashtë në një qasje brenda-qeveritare," tha Carsten Weber, drejtor i departamentit për të drejtat e njeriut dhe sundimin të ligjit pranë OSBE-së. "Këtë do ta bëjmë duke angazhuar ekspertë që të punojnë për çështje që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut (vendime, legjislacion, politika) me komuna, ministri dhe polici, në një rol këshilldhënës dhe ngritjen e kuadrove."

Aktualisht, OSBE-ja është duke diskutuar me IPVQ-në për të përcaktuar mënyrën se si po implementohet ky program. "Ideja jonë është të dërgojmë ekspertë për të drejtat e njeriut në secilën nga 30 komunat e Kosovës si dhe në pesë selitë rajonale të policisë. Për më tepër, ekspertë të lartë për të drejtat e njeriut do të caktohen në ministritë e zgjedhura," shton

Carsten Weber. Departamenti për të drejtat e njeriut do të mbajë tri njësi në nivelin qendror: monitorimin e sistemit ligjor, ngritjen e kuadrove dhe pikë kontaktin për çështje të trafikut.

"Vetë-qëndrueshmëria është shumë e rëndësishme për të gjitha aktivitetet e departamentit," thotë Carsten Weber. Duke u bazuar në këtë qëllim, departamenti për të drejtat e njeriut dhe sundimin të ligjit do të intensifikojë përpjekjet e veta për t'ia dorëzuar monitorimin e të drejtave të njeriut dhe raportimin OJQ-ve vendore që mirren me të drejtat e njeriut duke krijuar mirëkuptim të përgjithshëm të rëndësisë së monitorimit jo-qeveritar, duke u siguruar trajnime për këto OJQ dhe duke ndihmuar aktivitetet e tyre në mbledhjen e fondeve.

Sa i përket programit për sundimin e ligjit, vëmendja do të zhvendoset nga përkrahja

për zhvillimin e institucioneve të krijuara nga OSBE-ja për forcimin e sundimit të ligjit dhe sigurimin e qasjes në drejtësi, në këshillimin e këtyre institucioneve. Programi do të përkrahë Odën e Avokatëve në përpilimin e trajnimit për të promovuar sundimin e ligjit. Qendra Juridike e Kosovës do të vazhdojë të përkrahë fakultetin juridik në Kosovë dhe do të vazhdojë të implementojë programin 'e drejta për të gjithë'. Instituti Gjyqësor i Kosovës do të vazhdojë të ofrojë edukim ligjor për të gjithë gjykatësit dhe prokurorët e Kosovës. Eventualisht, do të shëndrrohet në shkollën e parë për gjyqtar të Kosovës. Qendra Burimore për Mbrojtje Penale Juridike, e themeluar nga OSBE-ja për të siguruar ekspertizë ligjore avokatëve mbrojtës vendor në aplikimin e të drejtave të njeriut dhe të drejtave ligjore ndërkombëtare, tani është tërësisht funksionale si një OJQ e pavarur.

## SHPK-ja: Fuqia e plotë të arrihet në 2005

nga Arni Snaevarr


Shkolla e shërbimit policor në Kosovë ka për qëllim që të aftësojë më tepër se 6,500 kadet të shërbimit policor të Kosovës (SHPK) në nivelin fillestar. Këtë vit do të aftësojë 700 kadet. Tashmë kanë diplomuar 6,223 fillëstarë por vetëm 5,643 prej tyre aktualisht janë shpërndarë në teren, pasi që 616 për arsye të ndryshme nuk janë duke shërbyer në forcat policore. "Kjo do të thotë se qëllimi i 6,533 kadeteve apo fuqia e plotë e SHPK-së do të arrihet deri në fund të 2005" thotë Steve Bennett, udhëheqës i departamentit të OSBE-së për zhvillimit dhe arsimim të policisë.

Vëmendje e rëndësishme ka kaluar nga trajnimi fillestar në trajnim të avancuar dhe të specializuar. Ky trajnim ndërton kapacitet me shërbimin policor të Kosovës ashtu që të mund të marrë përgjegjësi më të mëdha për aktivitetet e përditëshme policore dhe bartje plotësuese prej policisë së UNMIK-ut në atë të SHPK-së.

"Në vitin 2004 shkolla e policisë do përqëndrohet në vazhdimin e zhvillimit profesional" thotë Stiv Beneti. "një numër i mjaftueshëm i programeve të këtij viti u është dedikuar ngritjes së kapaciteteve vendore për t'ia mundësuar punonjësve vendor që të zëvendësojnë punonjësit ndërkombëtar në funksionet e zgjedhura institucionale" thotë z Beneti.

Kodet Penale, Kodet e Procedurave Kriminale dhe Kodet e Trafikut, janë pranuar ose janë nën rishikim të cialt do të kërkojnë trajnime vazhduese të të gjithë punonjësve të sistemit poli-

cor dhe të dretësisë. Gjatë 2004, përafërsisht 300 kadet të SHPK-së do të trajnohen në kurse për mbikëqyrje ose menaxhment.



# Dokumentari asnjëherë nuk përfundon, thjeshtë lihet mënjanë

Trajnuesi, Keith Bowers, ish-regjisor i BBC-së thotë se një film dokumentar nuk përfundohet kurrë. Dokumentari është një punë që vazhdon dhe që mund të editohet në mënyra të ndryshme. Ai thotë se ekzistojë një milion mënyra editimi të një filmi dokumentar.

nga Lizabeta Paloka

Seksioni për trajnim dhe përkrahje të mediave, në kuadër të departamentit për demokratizim pranë Misionit të OSBE-së në Kosovë, në bashkëpunim me organizatën norvegjeze 'Mediehogskolen', përfunduan me sukses një trajnim për xhirimin e filmave dokumentar. Trajnimi ka zgjatur 12 ditë - prej 19 deri më 30 janar. Katër epike, të përbëra prej pjesëmarrësve, të koordinuar dhe mbikëqyruar nga trajnuesi Keith Bowers, ish regjisor i BBC-së, përgaditën katër reportazhe të cilat përqëndroreshin kryesisht në jetën sociale, barazinë gjinore dhe trashëgiminë historike të Kosovës në formë të momenteve të vjetra.

"Mendoj se televizioni në Kosovë ka shënuar progres të konsiderueshëm që nga vizita ime e parë në Prishtinë para më shumë se tri viteve. Si duket, një numër i konsiderueshëm i gazetarëve televiziv kanë arritur të mësojnë gjërat elementare të gazetarisë televizive dhe tani ekzistojnë një qëllim dhe energji e mjaftueshme", tha z. Bowers.

Pjesëmarrës në këtë kurs/trajnim ishin gazetarët e 'RTK', 'KTV', 'TV21', 'TV Festina' (Ferizaj), 'TV Syri' (Gjakovë) dhe 'TV Dukagjini' (Pejë) dhe storië e tyre do të emetohen nga televizionet pjesëmarrëse. Koncepti i projektit përfshinë dy aspekte: trajnimin e gazetarëve në tregimin e storiëve të tyre duke përdorur fotografitë dhe reflektimi i problemeve sociale ose informimi i publikut për çështje të ndryshme.

Kualiteti i produktit final ishte më i mirë se që pritej dhe pjesëmarrësit mësuuan shkathtësi të reja si dhe ruajtën entuziazmin e tyre gjatë gjithë procesit.

"Do të ishte shumë mirë të shihnim një angazhim nga redaktorët dhe menaxherët që të avansojnë dhe të jenë të vendosur në zhvillimin e standardeve të përsosmërisë në stafin e tyre," tha Keith Bowers. "Kjo mund të jetë e vështirë duke marrë parasysh atmosferën politike dhe ekonomike këtu, por mund të fillohet duke pranuar se duhet arritur më tepër sa i përket njohurive profesionale. Gazetarëve të rinjë duhet t'u ipet kohë dhe duhet të inkurajohen për të zhvilluar shkathtësitë e tyre vizuale dhe në të shkruar. Qëllimi duhet të mbetet arritja e standardeve të gazetarisë televizive të Evropës perëndimore. Kjo nuk do të jetë e lehtë, por duhet të ekzistojë një vullnet i përbashkët për të vazhduar përpjekjet për tu përmirësuar.

Elementi më thelbësor i projektit ka qenë që pjesëmarrësit t'i ekspozohen metodave kryesore të përdorura në xhirimin e filmave dokumentar.

Metodat e trajnimit me theks të veçantë në teknikën profesionale të jetës reale dhanë rezultate pozitive. Një veçori tjetër e këndshme e kursit ishte bashkëpunimi i ngushtë në mes të pjesëmarrësve. Këto janë përmbledhjet e tregimeve reportazh:

## Vendi i harruar

Një nga vështirësitë me të cilën përballet populli i Kosovës në jetën e përditshme është mungesa e ujit të pijes, një nevojë elementare për çdo qenie njerëzore. Pjesëmarrësit e trajnimit shtruan këtë çështje duke bërë një reportazh në një fshat të rajonit të Malishevës. Personazhi kryesor i këtij reportazhi, z. Ismail Kastrati (65) nuk ka menduar kurrë se problemi që e kishte përcjellë atë gjatë gjithë jetës, mungesa e ujit të pastër për pije, do të ishte problem i pazgjidhur edhe për fëmijët e tij. Puset në fshat janë të ndotura sikur që është edhe lumi, i cili thahet tërësisht gjatë verës. Edhe pse familja e tij ka një standard mesatar të jetesës, të ardhurat e familjes nuk mund ta zgjidhin problemin e ujit të pijshëm. Vetëm familjet që kanë gjendje më të mirë materijale mund t'ia lejojnë vetes bartjen e ujit tri herë në javë nga një lum i largët por i pastër sepse rezervuaret, gjeneratorët dhe traktorët janë mjete të domosdoshme për të transportuar nevojat themelore të familjeve të tyre, përderisa familje të tjera shpesh përdorin ujin nga lumi i ndotur. Një ankesë i është dërguar komunës për ta zgjidhur këtë çështje. Kryetari i komunës ka theksuar faktin se kjo çështje është ngritur në takime me shumë organizata donatore ndërkombëtare, por asnjëherë nuk kanë marrë përgjigje pozitive. Qyteti i Malishevës ka të njëjtin problem, në ndërkohë që një projekt për të sjell ujë në qytet dhe Banjë, fshat në afërsi, pritet të fillojë në pranverë, duke lënë problemin në fshatin Turjakë të zgjidhet në vitin 2006. Jeta e banorëve të këtij fshati do të jetë më e lehtë nëse kjo do të ndodhë. Për disa njerëz kjo është një situatë e paimagjinuar, por jo për këta banorë të këtij fshati. Reportazhi përfundon me fytirat e rrudhura të fëmijëve duke bartur ujë me shpinën e tyre, për t'u ndihmuar familjeve të mbijetojnë.

## Shërbimi Policor i Kosovës

Ky raportazh ka për qëllim të njoftojë popullatën për rolin, vështirësitë dhe sfidat e femrave në Shërbimin Policor të Kosovës (SHPK). Policet femra përbëjnë 15% të numrit të përgjithshëm të SHPK-së. Personazhi kryesor i kësaj storië është znsh. Alije Elezi, një femer e pamartuar mbi të njëzetat, police e dilpomuar në SHPK në gjeneratën e njëzetedytë. Ajo i'u bashkangjiti SHPK-së para një viti e gjysmë në stacionin policor në veri të Prishtinës. Përmes saj, portretizohet një ditë e një policeje, detyrat në punë, disa prej rregullave që duhet t'u përmbahen, si duhet të sillen në raste rreziku, cilat janë mjetet e punës së tyre etj. Hobi i saj është kara-



Pjesëmarrës në sesionin trajnues për përgaditjes e 'Dokumentarit', mbajtur nga 19 deri më 30 janar në Prishtinë



Vlerësimi grupor i reportazheve dokumentare të përgaditura nga vetë pjesëmarrësit

teja, gjë që i ndihmon jashtëzakonisht shumë në punën e saj. Si femër, ajo ndihet rehat në punën e saj, edhe pse policët dhe policet ndeshen me rrezik të vazhdueshëm por përkrahja nga populli i Kosovës dhe dëshira për të kontribuar për sigurinë në Kosovë e bën punën e saj më të lehtë.

### Binarët e mjerimit

Hekurudha kalon mu në mes të qytetit të Ferizajit, duke shkaktuar aksidente të shumta të cilat rezultojnë me vdekje. Dokumentari me këtë temë reflekton shumë qartë asryet e këtij problemi, thjeshtë nuk ka mbrojtëse në udhëkryq. Derisa autoritetet e hekurudhës thonë se i takon komunës të vendos mbrojtëset, komuna ankohet për mungesë fondesh për të ndërtuar mbrojtëset, duke lënë qytetarët dhe veturat që kalojnë në udhëkryq të pasigurtë. Filmi paraqet të mbijetuarit e aksidenteve duke folur për tmerrin që ata kanë përjetuar dhe reflekton shqetësimin e qytetarëve për mospërfillje të problemit nga autoritetet.

### Hamami

Hamami i Prishtinës është një ndër monumentet më të vjetra historike të Kosovës. Është ndërtuar në shekullin e XV-të dhe ka punuar deri në vitin 1970. Reportazha ka për qëllim të tërheqë vëmendjen e autoriteteve komunale për një përkujdesje më të madhe të monumenteve të vjetra, të cilat janë të rëndësishme për qytetarët, pasi që janë dëshmi për historinë që e mësojnë gjeneratat e rinja. Programi paraqet Hamamin e vjetër dhe gërmadhat e hamamit sot, përveç një pjese të ndërtesës e cila është rindërtuar për të shërbyer si çajto. Një grua flet me nostalgji për kohën kur si fëmijë ka shkuar në Hamam dhe thotë se është në kërkim të monumentet e këtij lloji shëndrrohen në gërmadha. Një projekt i është dorëzuar komunës por fenomeni i shpeshtë mungesa e fondeve është pengesë.

## “Shpresojmë të na pranojnë”

“Kjo është hera e parë pas pesë viteve që e festojë ditëlindjen në shtëpinë time në Prishtinë,” thotë Vukosava Mitrovic, duke qëndruar në shkallë të shtëpisë së saj të renovuar në qendër të Prishtinës. Me 22 shkurt, gati një muaj pas kthimit në Kosovë, Vukosava festoi ditëlindjen e 68-të në qytetin e saj të lindjes.

nga Olja Stojanović

“Jam shumë e emocionuar, prandaj po qaj,” shpjegon Vukosava. “Nuk kam besuar se do të kthehem përsëri, se do ta shoh vendin ku jam rritur, ku e kam takuar burrin tim, ku e kam kaluar tërë jetën time.”

Vukosava dhe burri i saj, Dragoljub Mitrovic, janë serbet e parë të zhvendosur që u kthyen në Prishtinë nga Serbia, ku kanë kaluar pesë vite.

Bashkësia ndërkombëtare, duke përfshirë organizatat, Këshillin Danez për Refugjatë, Komitetin e Bashkuar Metodist për Ndhimë dhe Habitatin, kanë ndihmuar kthimin e tyre.

Këto organizata kanë renovuar shtëpinë e tyre të dëmtuar dhe i'u kanë siguruar ushqim elementar, artikuj higjienik dhe dru. Çiftit Mitrovic i janë dhënë edhe orendi, si karriga plastike, një tavolinë dhe dy kanape. Shtëpisë së renovuar akoma i vie era gëlqere.

“Dëshira ime më e madhe është që tani të mund të jetojmë normalisht dhe që të gjithë të jenë tolerant,” thotë Dragoljubi 70 vjeçar. “Një shqiptar të cilim e njohim nga e kaluara erdhi dhe na dëshiroi mirëseardhje. Shpresojmë se edhe të tjerët do të na pranojnë,” shtoi ai.

Pas arritjes së tyre në Prishtinë para një muaji, Vukosava dhe Dragoljubi qëndrarin kryesisht brenda në shtëpi. “Në fillim ishim të zënë duke pastruar dhe rregulluar shtëpinë,” thotë Vukosava. Por tani ata kanë filluar të dalin më shpesh.

“Kur kemi kohë, vizitojmë miqtë ose shkojmë në Gracanicë,” tha ajo. Ata shkojnë në Gracanicë për të blerë gjërat që i'u nevojiten, pasi pensionin, që bën 130 euro, e marrin në dinarë. Edhe ndihmën mjeksore, kur kanë nevojë për të, e marrin në enklavën serbe. “Autoritetet komunale kanë siguruar një linjë të rregulltë autobusi për në Gracanicë,” shpjeguan ata.

Dobri Miliq, një mësuese e gjuhës serbe 70 vjeçare, është anëtarja e tretë e këtij grupi të vogël të të kthyerve. Ajo përkohësisht jeton në shtëpinë e Mitrovicëve, por pret të kthehet në banesën e saj në pranverë, kur familja shqiptare që aktualisht jeton aty të jetë larguar.

Dobri, e cila është kthyer në Kosovë vetëm, thotë se nuk është frikësuar të kthehet në shtëpi. Ajo del për sheti dhe shkon në treg. Siç thekson edhe ajo vet, ka qenë e vendosur të kthehet në shtëpi.

“Kam vendosur të mos frikësohem. Kjo është

shtëpia ime. Shpresoj të vë kontakte me fqinjët e mi. Kjo mund të jetë e vështirë në fillim por besoj se do t'ia dalim mbanë,” thotë Dobri.

Vukosava, Dragoljubi dhe miqja e tyre Dobri shpresojnë se nuk do të jenë të kthyer e vetm. Në veçanti, do të dëshironin që familjet e tyre t'iu bashkangjiteshin në Prishtinë. Megjithatë, ata e dinë se kushtet duhet të përmirësohen për të mundur një kthim masiv.

“Nuk na pengon fakti që jetojmë së bashku me shqiptarët. Është realitet që e pranojmë,” përfundon Dragoljubi.

Ky grup i vogël i të kthyerve është i pari, por jo i fundit që kthehet në Prishtinë. Është prioritet kryesor i bashkësisë ndërkombëtare për të ndihmuar të zhvendosurit dhe refugjatët të cilët dëshirojnë të kthehen në Kosovë. Ky është prioritet edhe për Vukosavën, Dragoljubin dhe Dobriën, të cilët dëshirojnë të integrohen dhe të bindin të tjerët të kthehen.



Prishtina

# Në rrugë të vështirë të fjalës së lirë publike

"Asociacioni e gazetarisë 'Mediawest' në Pejë, shkollon kuadro me projekte multietnike në sfera të ndryshme të gazetarisë"

nga Dafina Elezi

Të ulur në një ambient jo edhe aq të përshtatshëm për mësim, 42 studentë të komuniteteve të ndryshme të Kosovës për një vit me radhë kanë ndjekur ligjëratat nga lëmi i gazetarisë. Profesori Musa Berisha, me një pëvojë të fituar për media nga 'Instituti Amerikan për Demokraci' nuk duket të jetë i lodhur nga teoritë që ua ka shpjeguar kandidatëve. Ata po i përgadiste për në rrugën e vështirë të fjalës së lirë publike.

Edhe unë që po e shkruaj këtë reportazh jamë bashkëudhëtar i kësaj rruge. Ndjeh që për një vit të kem marrë një shkop të fortë në dorë për të mbështetur hapat e mi në kallëderimin e fortë të kësaj rruge në kërkim të së vërtetës. "Kudo që shkoni, në cilindo burrim të informit, nisuni me guximin e madh profesional. Hulumtoni të vërtetën për të treguar fundamentin e gazetarisë dhe etikën njerëzore për fjalën e lirë publike", më kujtohen fjalët e profesor Berishës, kur na i shpjegonte burimet e informacionit.

## Ligjërues nga emra të njohur të gazetarisë

Teorinë e gazetarisë e ka dhënë profesori Musa Berisha, ndërsa praktikën gazetarët e shtypit të ditës Ibrahim Kelmendi 'Koha ditore', Enver Ulaj 'Zëri' dhe Rrahman Jasharaj 'Epoka e re'. Ndërsa gazetarinë e diplomacisë studentët e mësuar nga përvoja të cilën e kanë sjellë Augustin Palokaj dhe Sali Kelmendi.

"Kjo 'shkollë e gazetarisë' po nis drejt fjalës së lirë publike kolegë të mi të ardhshëm", thotë Palokaj, korespondent i "Kohës Ditore" nga Brukseli. Ai ishte edhe më i gëzuar për faktin se kjo 'shkollë' kishte filluar pikrisht në qytetin e tij.

## Suksesi i 'Mediawest-it'

'Shkolla e gazetarisë' është organizuar nga shoqata e gazetarëve 'Mediawest' në Pejë, të cilën e përbëjnë gazetarë profesionistë të shtypit të ditës. Drejtori i këtij asociacioni, Ibrahim Kelmendi thotë se ky është një fillim i guximshëm për të aftësuar kandidatë në fushën e gazetarisë, një sfidë për t'u takuar me një profesion, të cilin mund ta përfitosh, kur mbi një prirje të natyrshme vendos guximin dhe këmbëngulësinë.



Gazetarë të rinjë duke përcjell ligjëratat për gazetarinë themelore, organizuar nga asociacioni i gazetarëve 'Mediawest' në Pejë

Kelmendi i konsideron të suksesshëm të dy nivelet e para të shkollës njëveçare, të cilat i kanë ndjekur edhe 15 studentë të komunitetit boshnjak. Këtë e mbështet në faktin se 7 të diplomuar kanë zënë punë në media të ndryshme, ndërkohë që të tjerët po presin të gatshëm të konkurrojnë në ndonjë konkurs eventual të mediave të shkruara dhe elektronike dhe ate jo vetëm kosovare.

## Në frymën e edukimit perëndimor

E themeluar në vitin 2000, ndërsa e regjistruar më 5 qershor 2001, 'Mediawest' është i vetmi asociacion në nivel të Kosovës, që shkollon dhe edukon fjalën publike, gjithnjë në frymë të edukimit perëndimor. Në të njëjtën kohë përgatit edhe kuadrot që do të përdorin këtë fjalë për nevoja të zhvillimit të shoqërisë civile. Këtë aktivite e ka filluar në shkurt të vitit të kaluar dhe për 12 muaj në dy nivele ka aftësuar 42 studentë për teorinë dhe praktikën e zanatit të gazetarisë për media të shkruara dhe elektronike, varësisht nga afiniteti i tyre.

'Mediawest' është financuar tri herë nga USAID-i, nga një herë nga SOROS-i, IOM-i dhe së fundi është financuar nga OSBE-ja. "Ne pamë seriozitetin e kësaj organizate joqeveritare që kishte për qëllim aftësimin e kandidatëve për profesionin e gazetarisë, prandaj ne si zyrë e mediave nuk hezituar të financojmë këtë projekt, duke dashur që t'u japim një rast të rinjeve që kanë talent për fjalën e shkruar", thotë Xhemë Ibraj, përgjegjës për media në zyrën rajonale të OSBE-së në Pejë. Z. Ibraj shprehë gadishmërinë e kësaj zyre për të financuar të njëjtën projekt, por kesaj radhe do të implementohet në komunën e Deçanit.



## Buletini informativ 'Civic Herald'

nga Valentin Mitev

Departamenti për demokratizim dhe ekipi për pjesëmarrje civile dhe përkrahje të pajtimit pranë Misionit të OSBE-së në Kosovë ka përpiluar numrin e parë të buletini informativ elektronike 'Civic Herald' të premtën me 30 janar 2004. Buletini informativ shpërndahet në më shumë se 500 adresa, të cilat kanë qenë të angazhuara ose kanë ndjekur ngjarjet e dialogut civil ose aktivitete përkatëse. Marrësit janë OJQ-të vendore dhe ndërkombëtare, mediat lokale dhe rajonale, zyret ndërlidhëse në Kosovë, pikat e kontaktit për çështje gjinore, individ të interesuar dhe persona me ndikim.

'Civic Herald' ka për qëllim të informojë publikun në radhë të parë dhe promovojë iniciativat për dialog civil në Evropën jug-lindore, me vëmendje të posaçme në Kosovë dhe projektin për dialog civil me Serbinë. Projekti është implementuar nga Shoqata Nëna Terezë (SHNT) nga Prishtina dhe Qendra për Rajonalizim (QR) nga Novi Sadi me ndihmën e departamentit për demokratizim të OSBE-së dhe 'Fondacionit Freedom House' (Fondacion Amerikan që mbështet dialogun mes shoqërive civile).

Ky buletini informativ do të botohet çdo dy muaj dhe do të shpërndahet në tri gjuhë: anglisht, shqip dhe serbisht. E zhvilluar me resurset e OSBE-së, ky shërbim i vlefshëm ka për qëllim të ndihmojë rritjen rajonale dhe lokale, shkëmbimin e ideve dhe praktikave pozitive etj, të cilat do të lindin me pjesëmarrje të shtuar të SHNT-së dhe QR-së. Pra, një buletini informativ i standardit të lartë me një kapacitet të zhvilluar komunikimi do të merret përsipër nga homologët vendor në të mirë të grupeve të shoqërisë civile nga rajoni dhe agjencionet e interesuara nga komuniteti ndërkombëtar.

Detajet për kontakt të parapaguesve dhe marrësve të ardhshëm janë gjithashtu me interes. Ju lutemi, dërgoni komentet tuaja ose kërkesën për parapagim në e-mail adresën: [mario.maglov@omik.org](mailto:mario.maglov@omik.org)